

Ligj për trajnim dhe provim për drejtor të shkollës fillore, shkollës së mesme, konviktit të nxënësve dhe universitetit të hapur civil për mësim të përhjetshëm

TEKST I KONSOLIDUAR

("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 10/2015, 145/2015, 192/2015, 30/2016, 120/2018 dhe 140/2018 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 235/2024).

I. Dispozita të përgjithshme

Neni 1

Me këtë ligj rregullohen kushtet dhe procedurat për zbatimin trajnimit fillestar dhe të avancuar dhe provimit për drejtor të shkollës fillore, shkollës së mesme, konviktit të nxënësve dhe universitetit të hapur civil për mësim të përhjetshëm (në tekstin e mëtejshëm: shkolla).

Neni 2

Trajnimi themelor dhe i avancuar për kandidatin për drejtor (në tekstin e mëtejshëm: kandidati) zbatohet me qëllim që kandidati të marrë kompetenca të nevojshme profesionale për organizim, menaxhim të suksesshëm me punën edukativo-arsimore dhe administrimin e punës së shkollës.

Provimi për drejtor (në tekstin e mëtejshëm: provimi) realizohet për kontrollin e aftësisë profesionale të kandidateve për menaxhim, zbatim të dispozitave ligjore dhe organizim të punës në shkollë.

Trajnimi dhe provimi për kandidatë për drejtorë të shkollës fillore, përkatësisht shkollës së mesme, konviktit të nxënësve dhe universitetit të hapur civil për mësim të përhjetshëm zbatohet në pajtim me Programin për trajnim dhe provim të drejtorëve të shkollave fillore dhe të mesme.

Neni 3

Programin për trajnim dhe provim të drejtorëve të shkollës fillore dhe të mesme (në tekstin e mëtejshëm: Programi) i përcakton ministri i Arsimit dhe Shkencës (në tekstin e mëtejshëm: ministri), me propozim të Qendrës Shtetërore të Provimeve.

Në Program përcaktohen përmbajtjet e moduleve nga neni 9 paragrafi 2 i këtij ligji sipas të cilëve kandidati përgatitet për provim dhe përshkrimi i provimit.

Neni 4

Punët administrative dhe profesionale për nevojat e trajnimeve dhe provimin i kryen Qendra Shtetërore e Provimeve.

II. Kushte dhe procedura për zbatimin e trajnimit fillestar

Neni 5

Kandidatët për drejtore të shkollave fillore e marrin të drejtën e trajnimit fillestar nëse kanë së paku arsim të lartë, i plotësojnë kushtet për mësimdhënës ose bashkëpunëtor profesional në shkollë fillore dhe kanë së paku pesë vjet përvojë pune në punën edukative arsimore.

Kandidatët për drejtorë të shkollave të mesme e marrin të drejtën e trajnimit fillestar nëse kanë së paku arsim të lartë, i plotësojnë kushtet për mësimdhënës ose bashkëpunëtor profesional në shkollë të mesme dhe kanë së paku pesë vjet përvojë pune në punën edukative arsimore.

Kandidatet për drejtorë të konvikteve të nxënësve e marrin të drejtën e trajnimit fillestar nëse kanë më së paku arsim të lartë, i plotësojnë kushtet për edukator ose bashkëpunëtor profesional në punën edukativo-arsimore dhe kanë së paku pesë vjet përvojë pune në punën edukative arsimore.

Kandidatët për drejtorë të universitetit të hapur civil për mësim të përhershëm e marrin të drejtën për trajnim fillestar nëse kanë arsim të lartë dhe së paku pesë vjet përvojë pune.

Neni 6

Programin e realizojnë trajnues të zgjedhur në konkursi të shpallur nga Qendra Shtetërore e Provimeve.

Trajnuesit nga paragrafi 1 i këtij neni duhet t'i plotësojnë këto kushte të përgjithshme: të kenë së paku të kryer arsim të lartë - niveli VII A i kornizës nacionale të kualifikimeve, së paku pesë vjet përvojë pune në veprimtarinë edukativo-arsimore ose shkencore dhe përvojë si trajnues nga sfera e përmbajtjeve të modulit për të cilin konkurron.

Kushtet e veçanta për trajnues nga paragrafi 1 i këtij neni i përcakton Këshilli Drejtues i Qendrës Shtetërore të Provimeve, me propozim të drejtorit të Qendrës Shtetërore të Provimeve.

Trajnuesit zgjidhen për periudhë prej dy vitesh.

Trajnuesi nuk mund të jetë i punësuar në Qendrën Shtetërore të Provimeve, Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës, Qendrën për Arsim dhe Trajnim Profesional dhe Qendrën për Arsimin e të Rriturve.

Trajnuesit kanë të drejtë kompensimi me para për trajnim të mbajtur, që e përcakton Këshilli Drejtues i Qendrës Shtetërore të Provimeve.

Shuma e kompensimit në para nga paragrafi 6 i këtij neni përcaktohet në bazë të numrit të ditëve të trajnimeve të realizuara.

Neni 7

Paraqitja e kandidatëve për trajnim bëhet me shkrim me dorëzimin e fletëparaqitjes.

Me fletëparaqitje nga paragrafi 1 i këtij neni kandidati duhet të dorëzojë:

1. Diplomë për arsim e kryer përkatës të lartë;
2. Vërtetim për përvojën e punës në institucionin edukativo-arsimor të verifikuar nga Ministria e të lëshuar nga institucioni kompetent;
3. Biografi e shkurtër (rezyme, Curriculum vitae) dhe
4. Kopje të fletëpagesës për shumën e paguar për trajnim.

Fletëparaqitjet e kandidatëve nga paragrafi 1 i këtij neni dorëzohen dhe evidentohen në Qendrën Shtetërore të Provimeve.

Neni 8

Realizimi i trajnimit sipas Programit, për kandidatët e paraqitur fillon pas formimit të grupit prej dhjetë kandidatëve, të paraqitur për trajnim në pajtim me nenin 7 të këtij ligji.

Për kandidatët e paraqitur për trajnimin për drejtor mbahet dosje për çdo kandidat veç e veç.

Dosja e kandidatit deri te provimi përbëhet nga kërkesa për trajnimin e kandidatit, punë seminarike për secilin nga modulet në letër dhe në formë elektronike të lejuara nga trajnuesit.

Dosja e kandidatit për mbajtjen e provimit për drejtor, më së voni një muaj pas përfundimit të trajnimit në pajtim me Programin, dorëzohet te kryetari i Komisionit për Mbajtjen e Provimit për Drejtor (në tekstin e mëtejme: Komisioni i Provimit).

Neni 9

Kohëzgjatja e plotë e trajnimit është 192 orë dhe e njëjta është detyrueshme.

Trajnimi realizohet në pajtim me Programin me gjashtë module si vijojnë: Zbatimi i teknologjisë informatike-kompjuterike gjatë menaxhimit në arsim, Teoria e organizimit, Njerëzit në organizatë, Drejtori si udhëheqës pedagogjik, Legjislacioni dhe Financat.

Trajnimi ndahet në:

- trajnim i drejtpërdrejtë i cili zhvillohet në kohëzgjatje prej 18 orëve për një modul, të ndara në 12 sesione nga 90 minuta, të cilat realizohen në periudhën prej dy ditësh.
- punë individuale në kohëzgjatje prej 10 orësh për modul, kandidatët përgatitin punë seminarike në tema nga përmbajtjet e realizuara dhe
- prezantim në kohëzgjatje prej katër orësh, kandidatët e prezantojnë punimin e vet seminarik para grupit të trajnuesve.

Trajnuesi për modulet Teoria e organizatës, Njerëzit në organizatë detyrimisht e shfrytëzon edhe literaturën e profesionale që Ministria e siguron, shtyp dhe dorëzon në institucionet e arsimit të lartë.

Moduli do të konsiderohet i përfunduar nëse kandidati ka marrë pjesë në minimum dhjetë nga 12 sesionet dhe me sukses e ka prezantuar punimin seminarik.

Pas përfundimit të çdo moduli trajnuesi, në afat prej tri ditësh nga përfundimi i trajnimit, në Qendrën Shtetërore të Provimeve, dorëzon raport për prezantimin e suksesshëm të punimeve seminarike nga kandidatët dhe listën e evidencës për praninë e kandidatëve në trajnim.

III. Kushtet dhe procedura e realizimit të provimit

Neni 10

Të drejtën e dhënies së provimit e merr kandidati i cili me sukses e ka përfunduar trajnimin fillestar për drejtor dhe e ka dhënë testin psikologjik dhe testin e integritetit për drejtor, i cili nuk duhet të jetë më i vjetër se dy vjet.

Për zbatimin e testit psikologjik dhe testit të integritetit Qendra Shtetërore e Provimeve angazhon persona të licencuar profesionalë nga institucioni profesional.

Harxhimet për mbajtjen e testeve nga paragrafi 1 i këtij neni bie në llogari të kandidatit.

Neni 11

Pas trajnimit të realizuar, kandidati paraqitet për mbajtjen e provimit me paraqitjen e fletëparaqitjes në Qendrën Shtetërore të Provimeve. Në shtojcë të kërkesës kandidati dorëzon: bartës të regjistrimit elektronik (CD) me gjashtë punimet seminarike të moduleve, vërtetim për testin e dhënë psikologjik dhe testin e integritetit, ekzemplarë nga fletëpagesa për mjetet e paguara dhe punimin përfundimtar seminarik në tre ekzemplarë të shtypur.

Drejtori i Qendrës Shtetërore për provime, nga radhët e të punësuarve në Qendrën Shtetërore të provimeve përcakton person përgjegjës, i cili konstaton nëse kandidatët i plotësojnë kushtet për dhënien e provimit.

Personit përgjegjës nga paragrafi 2 i këtij neni për çdo sesion të mbajtur provimi i përket kompensim me para, në shumë prej një të tretën e neto pagës mesatare në Republikën e Maqedonisë së Veriut, për çka Qendra Shtetërore e Provimeve miraton aktvendim.

Kandidatët të cilëve u është miratuar kërkesa për dhënien e provimit dhe publiku informohen për datën dhe kohën e mbajtjes së provimit, së paku tetë ditë para mbajtjes së provimit nëpërmjet ueb faqes së Qendrës Shtetërore të Provimeve dhe Servisit Publik Riodifuziv.

Neni 12

Provimi për drejtor mbahet para Komisionit të provimit i formuar nga drejtori i Qendrës Shtetërore të Provimeve.

Komisioni i provimit përbëhet nga kryetari dhe katër anëtarë. Kryetari dhe një anëtar i Komisionit të provimit janë nga radhët e të punësuarve në Qendrën Shtetërore të Provimit, dy anëtarë janë nga radhët e të punësuarve në institucionet e arsimit të lartë, të cilët kanë të mbaruar së paku arsim të lartë VII/2 ose 300 kredi sipas Sistemit evropian të transferit të kredive (SETK) nga sferat e përfshira me modulet dhe një anëtar nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, që e propozon ministri për Arsimit dhe Shkencë.

Kryetari dhe anëtarët e komisionit kanë zëvendës të tyre.

Komisioni i provimit ka mandat prej katër vitesh. Kryetari dhe anëtarët e komisionit kanë të drejtë kompensimi në para që e përcakton Këshilli Drejtues i Qendrës Shtetërore të Provimit.

Shuma e kompensimit nga paragrafi 5 i këtij neni është në varshmëri nga numri i kandidatëve të cilët janë paraqitur për mbajtjen e provimit.

Neni 13

Provimi për drejtor përbehet nga tri pjesë:

- kontrolli praktik i shkathtësive kompjuterike,
- kontrolli i aftësisë për zbatimin e njohurive teorike dhe
- prezantimi dhe mbrojtja e punimit përfundimtar seminarik.

Pjesa e parë e provimit jepet me shfrytëzimin e kompjuterit për zgjidhjen një numri të caktuar të detyrave lidhur me zbatimin praktik të programeve softuerike dhe aplikimeve që shfrytëzohen në arsim dhe në punën në zyre.

Pjesa e dytë e provimit jepet me shfrytëzimin e kompjuterit dhe përbëhet nga kontrolli i njohurive teorike dhe shkathtësive të arritura gjatë trajnimit.

Pjesa e tretë e provimit përbehet nga prezantimi dhe mbrojtja e punimit përfundimtar seminarik të kandidatit.

Pjesën e parë dhe të dytë të provimit teknikisht e zbaton Qendra Shtetërore e Provimit, ndërsa pjesën e tretë të provimit e realizon Komisionit shtetëror i provimit.

Të gjitha pjesët e provimit mbahen në hapësirat e Qendrës Shtetërore të Provimeve.

Neni 14

Provimi për drejtor të shkollës mund të zgjasë më së shumti 150 minuta për të gjitha tri pjesët e provimit. Pjesa e parë e provimit është me kohëzgjatje deri në 60 minuta, pjesa e dytë e provimit është me kohëzgjatje deri në 60 minuta, ndërsa e treta me kohëzgjatje deri më së shumti 30 minuta.

Provimi organizohet së paku dy herë në vit për grupin prej së paku tre kandidatëve të paraqitur.

Nëse gjatë dhënies së provimit për drejtor krijohen shkaqe të arsyeshme për të cilat kandidatët nuk mund ta vazhdojë mbajtjen e provimit (sëmundje, pushim i shtatzënisë, lëndim, keqësim i gjendjes shëndetësore) për të cilën kandidati dorëzon vërtetim përkatës mjekësor, si dhe në raste të jashtëzakonshme fatkeqësie elementare ose tjetër, do të ndërpritet provimi për kohë të caktuar, e cila nuk mund të jetë më e gjatë se gjashtë muaj.

Vendim për vazhdimin e provimit miraton Qendra Shtetërore e Provimit me lutje të kandidatit. Lutja dorëzohet në afat prej tetë ditësh nga ndërprerja e shkaqeve për shtyrjen e provimit, por më së voni në afat prej gjashtë muajsh.

Nëse kandidati nuk dorëzon lutje për vazhdimin e provimit në afatin e përcaktuar në paragrafin 4 të këtij neni do të konsiderohet se provimin nuk e ka dhënë.

Kundër aktvendimit të Qendrës Shtetërore të Provimit nga paragrafi 4 i këtij neni kandidati mund të ngritë paraqesë në Komisionin Shtetëror për Vendimmarrje në Procedurë Administrative, në Procedurë të Marrëdhënies së Punës dhe në Mbikëqyrje Inspektuese në Shkallë të Dytë, në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit.

Në vazhdimin e provimit, kandidati për të cilin është miratuar vendimi nga paragrafi 4 i këtij neni, nuk e mban atë pjesë të provimit që paraprakisht tanimë e ka dhënë.

Neni 15

Pjesa e parë, e dytë dhe e tretë e provimit mbahen në hapësirat e mbajtjes së provimit, të pajisur veçanërisht me pajisje materiale-teknike dhe informatike, lidhje të internetit dhe pajisje për incizimin e dhënies së provimit.

Qendra Shtetërore për provime është e obliguar të bllokojë shtrirjen e radio frekuencave në hapësirën për dhënien e provimit gjatë zbatimit të sesioneve të provimit.

Agjencia për komunikime elektronike (në tekstin e mëtejme: AKE) zbaton monitorim të vazhdueshëm të bllokimit të shtrirjes së radiofrekuencave në hapësirën e dhënies së provimit, me qëllim të parandalohet çdo lloj i komunikimit elektronik me mjedisin e jashtëm nga hapësira për dhënien e provimit.

AKE në hapësirën për dhënien e provimit instalon pajisje matëse e cila siguron regjistrim elektronik nga matjet e kryera në kohëzgjatje prej 30 ditëve, dhe të njëjtat magazinohen në sistemin qendror kontrollues të AKE.

AKE formon komision prej tre anëtarëve që përpilon raport në bazë të regjistrimeve elektronike të magazinuara në sistemin qendror kontrollues të AKE dhe të njëjtin e parashtron në Ministrinë për arsim dhe shkencë, më së shumti në afat prej 30 ditëve nga data e mbajtjes së provimit.

Mbajtja e provimit incizohet dhe direkt emitohet në ueb faqen e Qendrës Shtetërore të Provimit, e nëse për shkaqe teknike incizimi ndërpritet, incizimi i provimit të plotë vendoset në ueb faqen e Qendrës Shtetërore të Provimeve.

Në hapësirën e mbajtjes së pjesës së parë dhe të dytë të provimit, gjatë mbajtjes së provimit janë të pranishëm tre përfaqësues: dy përfaqësues të Qendrës Shtetërore të Provimeve prej të cilëve njëri është anëtar i Komisionit të provimit, ndërsa i dyti është administrator dhe anëtar i Komisionit të provimit nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës.

Para fillimit të mbajtjes së pjesës së parë dhe të dytë të provimit, administratori e përcakton identitetin e kandidatit me kontrollin e dokumentit të vlefshëm për identifikim personal (letërnjoftim ose dokument udhëtimi).

Administratori ka të drejtë kompensimi në para që e përcakton Këshilli drejtues i Qendrës Shtetërore të Provimeve. Shuma e kompensimit varet nga numri i kandidatëve për provim.

Kandidatit gjatë mbajtjes së pjesës së parë dhe të dytë të provimit nuk i lejohet shfrytëzimi i telefonit celular, pajisjeve bartëse kompjuterike dhe mjeteve të tjera teknike dhe informatike, sendeve të përgatitura paraprakisht dhe të ngjashme.

Kandidatit gjatë kohës së mbajtjes së pjesës së parë dhe të dytë të provimit nuk i lejohet që të kontaktojë me kandidatë ose persona tjerë përveç me administratorin, në rast se ka probleme teknike me kompjuterin.

Nëse problemet teknike me kompjuterin mënjanohen për pesë minuta vazhdon provimi, e nëse nuk mënjanohen në këtë afat provimi vetëm për atë kandidatë ndërpritet dhe do të mbahet në afat prej tri ditësh nga dita e ndërprerjes së provimit.

Nëse ka probleme me më shumë se pesë kompjuterë dhe ato nuk mënjanohen në afat për pesë minuta provimi ndërpritet për tërë kandidatët që e mbajnë provimin dhe do të mbahet në afat më së shumti prej tri ditësh nga dita e ndërprerjes së provimit.

Nëse kandidati gjatë testimit në pjesën e parë dhe të dytë të provimit vepron në kundërshtim me paragrafët 10 dhe 11 të këtij neni, nuk do të lejohet të vazhdojë me testimin në atë sesion testimi dhe i shqiptohet ndalesë për dhënie të provimit në kohëzgjatje prej tre viteve, për çka Qendra Shtetërore e provimeve miraton aktvendim kundër të cilit mund të nisest kontest administrativ pranë gjykatës kompetente në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimit të aktvendimit.

Në rastet nga paragrafi 14 i këtij neni, llogaritet se kandidati nuk e ka dhënë provimin dhe i njëjti konstatohet në procesverbalin për mbajtjen e provimit për drejtor.

Përfaqësuesit e autorizuar nga paragrafi 7 i këtij neni, gjatë kohës së mbajtjes së provimit nuk guxojnë të qëndrojnë më gjatë se pesë sekonda në afërsi të drejtpërdrejtë të kandidatit i cili e mban provimin, përveç në raste mënjanimi të problemeve teknike kur nuk guxojnë të qëndrojnë më gjatë se pesë minuta.

Neni 16

Pjesa e parë e provimit përbëhet nga testi me tri detyra nga sistemi elektronik lidhur me zbatimin praktik të programeve të softuerit dhe aplikacioneve që shfrytëzohen në arsim dhe testi me tri detyra nga sistemi elektronik lidhur me zbatimin praktik të programeve të softuerit dhe aplikacioneve që shfrytëzohen në punën në zyrë.

Sistemi elektronik përmban së paku 50 detyra të cilat i përgatisin persona profesionistë të angazhuar nga Qendra Shtetërore e Provimeve.

Personat profesional nga paragrafi 2 i këtij neni bëjnë revizion dhe azhurnim të detyrave nga paragrafi 2 i këtij neni së paku dy herë në vit.

Në bazë të revizionit dhe azhurnimit të kryer, personat profesional vendosin së paku 30% e detyrave të ndryshohen ose plotësisht të zëvendësohen me të reja.

Për pjesën e parë të provimit administratori jep udhëzime për zgjidhjen e të njëjtës, para fillimit të mbajtjes së provimit.

Sistemi elektronik nuk lejon ekzistimin e testit identik për pjesën e parë të provimit në një sesion për më shumë se një kandidat.

Kandidati detyrat i zgjidh në kompjuter.

Detyrat nga testi vlerësohen me pikë të përcaktuara në test.

Pjesa e parë e vlerësohet me kaloi/nuk kaloi, në bazë të regjistrimit nga testi i dhënë elektronik që e dorëzon administratori në Komisionin e Provimeve. Regjistrimi nga pjesa e parë e provimit ruhet në dosjen e kandidatit.

Llogaritet se pjesën e parë të provimit e ka dhënë ai kandidat i cili me përgjigje të sakta të pyetjeve nga testi ka arritur më së paku 60% nga numri i përgjithshëm i pikëve të parapara.

Nëse kandidati nuk e ka dhënë pjesën e dytë dhe/ose të tretë të provimit në afat prej gjashtë muajve pas dhënies së pjesës së parë të provimit, është i obliguar që pjesën e parë të provimit sërish ta japë.

Neni 17

Pjesën e dytë të provimit e jep nëse me sukses e ka kaluar pjesën e parë të provimit.

Në pjesën e dytë të provimit kandidati në kompjuter zgjidh 30 pyetje nga njohuritë teorike të arritura nga modulet gjatë trajnimit.

Pyetjet janë me katër opsione për rrethim prej të cilave njëra është e saktë, ndërsa tri janë të pasakta.

Detyrat nga testi vlerësohen me pikë të përcaktuara në test.

Pyetjet përmbahen në sistemin elektronik, ndërsa i përgatisin trajnuesit, nga 60 pyetje nga çdo modul, përkatësisht gjithsej 300 pyetje. Pyetjet janë të arritshme publikisht në ueb faqen e Qendrës Shtetërore të Provimeve.

Trajnuesit nga paragrafi 5 i këtij neni bëjnë revizion dhe azhurnim të detyrave nga paragrafi 5 i këtij neni së paku dy herë në vit.

Në bazë të revizionit dhe azhurnimit të kryer, trajnuesit vendosin së paku 30% e detyrave të ndryshohen ose plotësisht të zëvendësohen me të reja.

Komisioni i Provimeve i verifikon pyetjet.

Për pjesën e dytë të provimit administratori jep udhëzim për zgjidhjen e të njëjtës, para fillimit të dhënies së provimit.

Sistemi elektronik nuk lejon ekzistimin e përmbajtjes identike për pjesën e dytë të provimit në një sesion për më shumë se një kandidat.

Pjesa e dytë e provimit vlerësohet me kaloi/nuk kaloi, në bazë të regjistrimit nga testi i dhënë elektronik që e dorëzon administratori në Komisionin e Provimeve Regjistrimi nga pjesa e dytë e provimit ruhet në dosjen e kandidatit.

Llogaritet se pjesën e dytë të provimit e ka dhënë ai kandidat i cili me përgjigje të sakta të pyetjeve nga testi ka arritur më së paku 60% nga numri i përgjithshëm i pikëve të parapara.

Për rezultatet e pjesës së dytë të provimit kandidati do të njoftohet më së voni tri ditë pas dhënies së provimit.

Neni 18

Pjesën e tretë të provimit kandidati e jep nëse me sukses e ka kaluar pjesën e dytë të provimit.

Për pjesën e tretë të provimit kandidati përpunon, prezanton dhe mbron punim përfundimtar seminarik - studim të rastit.

Temën e punimit përfundimtar seminarik kandidati e merr pas përfundimit të trajnimit, të gjeneruar me kompjuter, përmbajtjen e të cilës me zgjedhje të rastësishme e përcakton softueri i sistemit elektronik nga lista e temave.

Temat për listën nga paragrafi 3 të këtij neni i përgatisin trajnuesit nga 20 tema për çdo modul, përkatësisht gjithsej 120 tema.

Komisioni i Provimeve i verifikon temat.

Trajnuesit nga paragrafi 4 i këtij neni bëjnë revizion dhe azhurnim të detyrave nga paragrafi 4 i këtij neni së paku dy herë në vit.

Në bazë të revizionit dhe azhurnimit të kryer, trajnuesit vendosin së paku 30% e temave të ndryshohen ose plotësisht të mënjanohen dhe zëvendësohen me të reja.

Punimin përfundimtar seminarik e përgatit, prezanton dhe mbron në afat prej 30 ditësh nga dita e marrjes së temës.

Kandidati punimin përfundimtar seminarik e prezanton dhe mbron para Komisionit të Provimeve.

Komisioni i Provimeve në mënyrë të plotfuqishme vendos nëse janë të pranishëm të gjithë anëtarët e vet.

Kur ndonjë anëtar nga Komisioni i Provimeve është i penguar të marrë pjesë në provimin i cili realizohet, në vendin e tij thirret zëvendësi i tij.

Vendimet nga Komisioni i Provimeve miratohen me shumicën e votave.

Pjesën e tretë të provimit Komisioni i Provimeve e vlerëson me kaloi/nuk kaloi, në bazë të punimit përfundimtar seminarik të përgatitur, prezantuar dhe mbrojtur. Kandidati njëherë njoftohet për notën e Komisionit të Provimeve.

Llogaritet se kandidati e ka dhënë provimin nëse me suksesi i ka dhënë të gjitha pjesët e provimit.

Për rezultatet e dhënies së provimit Qendra Shtetërore e Provimeve e njofton kandidatin, më së voni në afat prej 15 ditësh.

Kundër aktvendimit për mosdhënie të provimit për drejtor, të miratuar nga Qendra Shtetërore e Provimeve, mund të paraqitet ankesë në Komisionin Shtetëror për Vendimmarrje në Procedurë Administrative, në Procedurë të Marrëdhënies së Punës dhe

në Mbikëqyrje Inspektuese në Shkallë të Dytë, në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit.

Neni 19

Për rrjedhën e provimit mbahet procesverbal në të cilin futen këto të dhëna: emri dhe mbiemri i kandidatit, përbërja e komisionit të provimit, data e dhënies së pjesëve të provimit, titulli i punimit seminarik përfundimtar, rezultatet e tri pjesëve të provimit, nota përfundimtare për provimin dhe vërejtje tjera më të rëndësishme nga rrjedha e provimit.

Procesverbali nënshkruhet nga kryetari dhe anëtarët e Komisionit të provimit.

Pas përfundimit të provimit, dosja e kandidatit plotësohet me fletëparaqitjen për provim, procesverbalin nga provimi i realizuar, bartësin e regjistrimit elektronik (CD) me gjashtë punime seminarike dhe punimin përfundimtar seminarik që ruhen në Qendrën Shtetërore të Provimeve.

Forma dhe përmbajtja e procesverbalit nga paragrafi 1 i këtij neni përcaktohet nga drejtori i Qendrës Shtetërore të Provimeve.

Neni 20

Kandidatët që nuk a kanë dhënë provimin mund ta japin provimin në cilindo afat tjetër të radhës, me fletëparaqitje të re dhe ekzemplar të fletëpagesës së re për mjetet e paguara për provim.

Kandidatët që nuk kanë ardhur në provim kanë të drejtë që të njëjtin ta japin në cilindo afat tjetër të radhës me fletëparaqitje të re dhe ekzemplar nga fletëpagesa e kaluar.

Kandidatët që edhe për herën e tretë nuk e kalojnë provimin, nuk kanë të drejtë ta japin provimin në tri vitet e ardhshme.

IV. Kushtet dhe procedura e zbatimit të trajnimit të avancuar

Neni 21

Trajnim të avancuar detyrimisht ndjek drejtori i shkollës me provim të dhënë për drejtor.

Neni 22

Për mbindërtim të njohurive, drejtorët e shkollave janë të obliguar të ndjekin trajnim për përsosje të vazhdueshme profesionale nga më së paku katër ditë seminarike, me kohëzgjatje të përgjithshme nga më së paku 32 orë, gjatë një viti.

Trajnimin nga paragrafi 1 të këtij neni e organizon Qendra Shtetërore e Provimeve.

Trajnues në trajnimin e avancuar janë persona profesionalë nga radhët e të punësuarve në Qendrën Shtetërore të Provimeve, persona profesionalë të punësuar në institucione nga sfera e arsimit dhe persona profesionalë nga institucione/ente tjera lidhur me tema nga përmbajtja e Programit për trajnim të avancuar të drejtorit, të caktuar nga drejtori i Qendrës Shtetërore të Provimeve.

Programin për trajnimin e avancuar të drejtorit e përcakton ministri, i cili e propozon në bashkëpunim me Byronë për Zhvillim të Arsimit, Qendrën për Arsim Profesional dhe Trajnim, Qendrën për Arsim të të Rriturve dhe Inspektoratin Shtetëror të Arsimit.

Trajnuesit kanë të drejtë në kompensim në para që e përcakton Këshilli Drejtues i Qendrës Shtetërore të Provimeve.

Lartësia e kompensimit nga paragrafi 5 të këtij neni është për ditë seminarike.

Për pjesëmarrje në trajnim të avancuar Qendra Shtetërore e Provimeve drejtorëve u lëshon vërtetim dhe të njëjtën e evidenton.

Formën dhe përmbajtjen e vërtetimit për pjesëmarrje në trajnimin e avancuar të drejtorëve i përcakton drejtori i Qendrës Shtetërore të Provimeve.

V. Baza e të dhënave, certifikata dhe shpenzimet

Neni 23

Evidenca për drejtor mbahet në bazën e të dhënave, e publikuar në ueb faqen e Qendrës Shtetërore të Provimeve.

Evidenca nga paragrafi 1 i këtij neni mbahet në pajtim me Ligjin për procedurë të përgjithshme administrative.

Baza nga paragrafi 1 të këtij neni përbëhet nga dy pjesë:

- Evidenca për persona të cilët kanë marrë certifikatë për drejtor dhe i përmban të dhënat në vijim: emrin dhe mbiemrin, komunën, datën e lëshimit të certifikatës, datën e heqjes së certifikatës.

- Evidenca për persona të cilët janë drejtorë të shkollave dhe i përmban të dhënat në vijim: emrin dhe mbiemrin, komunën, datën e lëshimit të certifikatës, datën e heqjes së certifikatës, ditët e ndjekura seminarike dhe temat në suaza të trajnimit të avancuar, shkollën në të cilën është drejtor, postën elektronike dhe numrin telefonik zyrtar.

Të dhënat nga baza i azhurnon Qendra Shtetërore e Provimeve, në bazë të të dhënave të marra nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe njësitë e vetëqeverisjes lokale në rajonin e së cilës është shkolla.

Ministria e Arsimit dhe Shkencës dorëzon të dhëna për drejtorët e shkollave shtetërore fillore dhe të mesme dhe konviktet shtetërore të nxënësve, kurse kryetari i komunës, komunës në Qytetin e Shkupit, respektivisht Qytetit të Shkupit për shkollat fillore dhe të mesme komunale, konviktet e nxënësve dhe universitetet e hapura civile për mësim të përjetshëm, në afat prej dhjetë ditëve nga dita e zgjedhjes, respektivisht shkarkimit të drejtorit.

Neni 24

Kandidatit i cili e ka kaluar provimin i lëshohet certifikatë për provim të kaluar për drejtor, të nënshkruar nga kryetari të Komisionit të provimit dhe nga Qendra Shtetërore e Provimeve, në afat prej shtatë ditëve nga dita e mbarimit të provimit.

Formën dhe përmbajtjen e Certifikatës për provim të kaluar për drejtor i përcakton ministri i Arsimit dhe Shkencës, me propozim të Qendrës Shtetërore të Provimeve.

Neni 25

Vlefshmëria e certifikatës për drejtor ndërpritet nëse kandidati për drejtor i cili e posedon nuk zgjidhet për drejtor në periudhë prej pesë vjetësh nga dita e lëshimit të certifikatës.

Në rastin nga paragrafi 1 i këtij neni kandidati për drejtor ka të drejtë të marrë certifikatë të re me ndjekje të sërishme të trajnimit dhe dhënie të provimit për drejtor.

Për ndjekje të sërishme të trajnimit dhe dhënie të provimit, kandidati për drejtor është i detyruar të paraqesë fletëparaqitje për trajnim dhe fletëparaqitje për provim dhe t'i paguajë shpenzimet.

Neni 26

Qendra Shtetërore e Provimeve me aktvendim e heq certifikatën e peronit i cili për momentin e ushtron funksionin drejtor nëse:

- përcaktohen parregullsi në dhënien e provimit,
- nuk e ka plotësuar minimumin vjetor nga katër ditë seminarike nga trajnimi i avancuar,
- i është shqiptuar ndalim për ushtrimin e profesionit, veprimtarisë ose detyrës, me ditën e plotfuqishmërisë së aktgjykimit gjyqësor dhe
- nëse është miratuar aktgjykim gjyqësor për vepra penale të bëra në lidhje me kryerjen e shërbimit me të cilin i është shqiptuar dënim me burg pa kusht mbi gjashtë muaj.

Neni 27

Për heqjen e certifikatës për drejtor propozim jep Komisioni për Revizion dhe për Heqjen e Certifikatës për Drejtor.

Komisionin nga paragrafi 1 nga ky nen e formon ministri i Arsimit dhe Shkencës.

Komisioni nga paragrafi 1 i këtij neni përbëhet nga: dy përfaqësues nga të punësuarit në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës, të caktuar nga ministri i Arsimit dhe Shkencës, një përfaqësues nga të punësuarit në Inspektoratin Shtetëror të Arsimit, të caktuar nga drejtori i Inspektoratit Shtetëror të Arsimit, një përfaqësues nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe një informatikan nga Ministria e Transformimit Dixhital, e caktuar nga ministri i Transformimit Dixhital.

Komisioni nga paragrafi 1 i këtij neni mban mbledhje pas çdo sesioni të mbajtur testues dhe kryen revizion të zbatimit të provimit, duke përfshirë edhe atë nëse provimin e kanë dhënë kandidatë të cilët i plotësojnë kushtet për dhënien e provimit në pajtim me nenin 10 paragrafi 1 i këtij ligji, për çka parashtron raport te ministri për Arsimit dhe Shkencë.

Anëtarëve të komisionit nga paragrafi 1 i këtij neni u përket kompensim me para, që në nivel vjetor është një rrogë mesatare neto në Republikën e Maqedonisë së Veriut, për çka Qendra Shtetërore për Provime miraton aktvendim.

Nëse Komisioni nga paragrafi 1 i këtij neni konstaton parregullsi në zbatimin e provimit, propozon heqje të certifikatës nga neni 24 të këtij ligji.

Neni 28

Komisioni për Revizion dhe për Heqjen e Certifikatës për Drejtor te drejtori i Qendrës Shtetërore të Provimeve dorëzon propozim për heqje të certifikatës për drejtor.

Drejtori i Qendrës Shtetërore të Provimeve miraton aktvendim për heqjen e certifikatës për drejtor, në bazë të propozimit me shkrim të Komisionit nga paragrafi 1 i këtij neni, në afat prej shtatë ditësh nga pranimi i propozimit.

Nëse drejtori i Qendrës Shtetërore të Provimeve nuk miraton aktvendim për heqjen e certifikatës për drejtor në afatin e përcaktuar në paragrafin 2 të këtij neni, aktvendim për heqjen e certifikatës për drejtor miraton ministri i Arsimit dhe Shkencës.

Kundër aktvendimit për heqjen e certifikatës për drejtor mund të paraqitet ankesë në Komisionin Shtetëror për Vendimmarrje në Procedurë Administrative, në Procedurë të

Marrëdhënies së Punës dhe në Mbikëqyrje Inspektuese në Shkallë të Dytë, në afat prej 15 ditësh nga pranimi i aktvendimit.

Pas përfundimit të aktvendimit për heqjen e certifikatës për drejtor aktvendimi dorëzohet në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës, Inspektoratin Shtetëror të Arsimit dhe njësitë e vetëqeverisjes lokale në territorin e të cilës është shkolla dhe e njëjta futet në evidencën nga neni 23 paragrafi 1 i këtij ligji.

Neni 29

Shpenzimet për trajnimin themelor, për trajnimin e avancuar, për dhënien e provimit dhe për certifikatën janë në ngarkim të kandidatit.

Lartësinë e kompensimit nga paragrafi 1 i këtij neni e përcakton drejtori i Qendrës Shtetërore të Provimeve në bazë të shpenzimeve të bëra reale për trajnimet, provimin dhe certifikatën.

Shpenzimet nga paragrafi 1 i këtij neni paguhet në llogari të të ardhurave personale të Qendrës Shtetërore të Provimeve.

Neni 30

Qendra Shtetërore e Provimeve do t'i shfrytëzojë të dhënat personale të kandidatit për drejtor në pajtim me rregullat për mbrojtje të të dhënave personale.

Mënyra e sigurimit dhe shkëmbimit të të dhënave personale të kandidatit për drejtor, kurse të cilat janë të nevojshme për dhënien e certifikatës ose për formimin e bazës publike për evidencë, kryhet në pajtim me rregullat për mbrojtje të të dhënave personale.

Formën dhe përmbajtjen e formularëve për sigurimin e të dhënave personale i përcakton drejtori i Qendrës Shtetërore të Provimeve.

Neni 31

Mbikëqyrje ndaj zbatimit të këtij ligji kryen Ministria.

Mbikëqyrje inspektuese mbi zbatimin e dispozitave të këtij ligji dhe rregullave të miratuara në bazë të këtij ligji kryen Inspektorati Shtetëror i Arsimit.

VI. Dispozita kundërvajtëse

Neni 32

Gjobë në shumë prej 10.000 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet Qendrës Shtetërore për Provime nëse nuk e bllokoi shtrirjen e radio frekuencave në hapësirën për dhënien e provimit në pajtim me nenin 15 paragrafi 2 i këtij ligji.

Gjobë në shumë prej 5.000 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet Qendrës Shtetërore për provime nëse nuk incizon, nuk e transmeton drejtpërdrejtë në ueb faqen e Qendrës Shtetërore për provime dhe nëse nuk e publikon incizimin e provimit të plotë në ueb faqen e Qendrës Shtetërore të provimeve në pajtim me nenin 15 paragrafi 6 i këtij ligji.

Gjobë në shumë prej 30% të gjobës së llogaritur për personin juridik do t'i shqiptohet për kundërvajtjen nga paragrafi 2 i këtij neni personit përgjegjës në personin juridik.

Gjobë prej 2.000 deri 3.000 euro në kundërvlerë me denarë do të dënohet personi nga neni 11 paragrafi 2 i këtij ligji i cili do të lejojë të jep provim kandidat i cili nuk i plotëson kushtet e caktuara me këtë ligj.

Gjobë në shumë prej 2.000 deri 3.000 euro në kundërvlerë me denarë do t'u shqiptohet përfaqësuesve të autorizuar nga neni 15 paragrafi 7 i këtij ligji nëse lejojnë kandidatët të veprojnë në kundërshtim me nenin 15 paragrafët 10, 11 dhe 16 të këtij ligji.

Gjobë në shumë prej 100 deri 200 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtje kandidatit i cili vepron në kundërshtim me nenin 15 paragrafët 10 dhe 11 të këtij ligji.

Gjobë në shumë prej 2.000 deri 3.000 euro në kundërvlerë me denarë do t'u shqiptohet për kundërvajtje anëtarëve të komisionit nga neni 27 paragrafi 1 i këtij ligji nëse konstatojnë parregullsi në zbatimin e provimit dhe nuk parashtrojnë propozim për marrjen e certifikatës në pajtim me nenin 27 paragrafin 6 të këtij ligji.

Gjobë në shumë prej 1.000 deri 1.500 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtje drejtorit të Qendrës Shtetërore për provime nëse nuk miraton aktvendim për marrjen e certifikatës për drejtor në afatin e caktuar në nenin 28 paragrafi 2 i këtij ligji.

Neni 32-a

Matja e lartësisë së gjobës për personin juridik bëhet në pajtim me Ligjin për kundërvajtje.

Neni 32-b

Për kundërvajtjet e përcaktuara në nenin 32 të këtij ligji, inspektori shtetëror i arsimit detyrohet kryerësit të kundërvajtjes t'i lëshojë urdhërpagesë të kundërvajtjes, në pajtim me Ligjin për kundërvajtje.

Nëse kryerësi e pranon urdhërpagesën e kundërvajtjes, të njëjtin duhet ta nënshkruajë. Pranimi i urdhërpagesës së kundërvajtjes nga kryerësi i kundërvajtjes shënohet në procesverbal.

Në procesverbalin nga paragrafi (2) i këtij neni përcaktohet mënyra në të cilën do të mënjahen pasojat e dëmshme nga kundërvajtja, si dhe mënyra e tejkalimit të pasojave nga kryerësi i kundërvajtjes.

Kur si kryerës i kundërvajtjes paraqitet personi juridik, procesverbalin dhe urdhërpagesën e kundërvajtjes e nënshkruan personi përgjegjës në personin juridik apo prej tij personi i autorizuar.

Inspektori shtetëror i arsimit detyrohet të mbajë evidencë për urdhërpagesat e kundërvajtjes të lëshuara dhe për rezultatin e procedurave të ngritura.

Në evidencën nga paragrafi (5) të këtij neni mblidhen, përpunohen dhe ruhen të dhënat në vijim: emri dhe mbiemri, përkatësisht emërtimi i kryerësit të kundërvajtjes, vendbanimi, përkatësisht vendqëndrimi, selia, lloji I kundërvajtjes, numri i urdhërpagesës së kundërvajtjes që I lëshohet dhe rezultati i procedurës.

Të dhënat personale nga paragrafi (6) të këtij neni ruhen pesë vjet nga dita e futjes në evidencë.

Ministri i Arsimit dhe Shkencës e përcakton formën dhe përmbajtjen e urdhërpagesës së kundërvajtjes.

Neni 33

Për kundërvajtjet të parapara me këtë ligj procedurë kundërvajtëse mban dhe sanksion kundërvajtës shqipton gjykata kompetente.

VII. Dispozita kalimtare dhe përfundimtare

Neni 34

Aktet nënligjore të parapara me këtë ligj do të miratohen më së voni 60 ditë nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 35

Qendra Shtetërore e Provimeve e përgatit dhe shpall bazën për evidencë më së voni deri në ditën e fillimit të zbatimit të këtij ligji.

Qendra Shtetërore e Provimeve e vendos sistemin unik elektronik për dhënien e provimit për drejtorë më së voni deri në ditën e fillimit të zbatimit të këtij ligji.

Neni 36

Procedurat e filluara për trajnim dhe dhënie të provimit për drejtor deri në ditën e fillimit të zbatimit të këtij ligji do të përfundojnë sipas dispozitave të rregullave sipas të cilave kanë filluar.

Neni 37

Kandidatët të cilët janë pajisur me certifikatë për drejtor në pajtim me rregullat në fuqi deri në ditën e fillimit të zbatimit të këtij ligji, janë të detyruar më së voni deri më 1 shtator 2020 ta japin provimin për drejtor dhe të pajisen me certifikatë për drejtor në pajtim me dispozitat e këtij ligji.

Neni 38

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e tetë nga dita e botimit të tij në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë", kurse do të fillojë të zbatohet prej 1 tetori 2016.2

DISPOZITA NGA LIGJET PËR NDRYSHIM DHE/OSE PLOTËSIM

Ligj për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për trajnim dhe provim për drejtor të shkollës fillore, shkollës së mesme, konviktit të nxënësve dhe universitetit të hapur civil për mësim të përjetshëm ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 145/2015):

Neni 4

Akti nënligjor i përcaktuar me këtë ligj do të miratohet në afat prej 30 ditësh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Ligj për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për trajnim dhe provim për drejtor të shkollës fillore, shkollës së mesme, konviktit të nxënësve dhe universitetit të hapur civil për mësim të përjetshëm ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 145/2015):

Neni 6

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e botimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë".

Ligj për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për trajnim dhe provim për drejtor të shkollës fillore, shkollës së mesme, konviktit të nxënësve dhe universitetit të hapur civil për mësim të përjetshëm ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 30/2016):

Neni 6

Dispozitat nga nenet 1, 2, 3 dhe 4 të këtij ligji, do të fillojnë të zbatohen me fillimin e zbatimit të Ligjit për procedurë të përgjithshme administrative, në pajtim me nenin 141 të Ligjit për procedurë të përgjithshme administrative ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 124/15).

Neni 7

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e botimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë".

Ligj për ndryshimin e Ligjit për trajnim dhe provim për drejtor të shkollës fillore, shkollës së mesme, konviktit të nxënësve dhe universitetit të hapur civil për mësim të përjetshëm ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 140/2018):

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e botimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë".

Ligj për ndryshimin e Ligjit për trajnim dhe provim për drejtor të shkollës fillore, shkollës së mesme, konviktit të nxënësve dhe universitetit të hapur civil për mësim të përjetshëm ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 235/2024):

Neni 4

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e botimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut".